



BASHKIA
TIRANË



Drejtuar: Operatorit Ekonomik "M.Lezha shpk

Adresa: Shkodër, Zona Industriale, Rruga Lëvizja e Postribës, nr. Pasurie 11/200, zona kadastrale 8592

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: **"Paisja me orendi e 4 mencave në shkollat ku do të implementohet projekti "Bëjmë detyrat e shtëpisë"**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Paisja me orendi e 4 mencave në shkollat ku do të implementohet projekti "Bëjmë detyrat e shtëpisë"**, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit

Fondi limit: **5.380.500** (pesë milion e treqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind) **lekë pa TVSH.**

Nr. REF -83755-08-24-2018

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit Nr. 132 datë 21.12.2017 për "Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018" i ndryshuar, konfirmuar nga prefekti i Qarkut Tiranë.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: datë 11.09.2018 , ora 11:00

Publikime të mëparshme: *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike nr.35 datë 03.09.2018**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik "M.LEZHA" shpk me nr. NUIS J76504013C
Vlera e ofertës pa TVSH = **4.037.600** (katër milion e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) **lekë**

2. Operatori Ekonomik "ERZENI/SH" shpk me nr. NUIS J66902027T
Vlera e ofertës pa TVSH = **5.306.600** (pesë milion e treqind e gjashtë mijë e gjashtëqind) **lekë.**

3. Operatori Ekonomik "RO – AI" shpk me nr. NUIS J61811001M
Vlera e ofertës pa TVSH = **4.678.800** (katër milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) **lekë.**

4. Operatori Ekonomik “Bolt” shpk me nr. NUIS K91517011V
Vlera e ofertës pa TVSH = **4.099.000** (katërmilion e nëntëdhjetë e nëntë mijë) **lekë**.

5. Operatori Ekonomik “Dajti Construxion” shpk me NUIS J92211003P
Vlera e ofertës pa TVSH = **4.558.000** (katër milion e pesëqind e pesëdhjetë tetë mijë) **lekë**.

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

1- Operatori Ekonomik “Bolt” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik **“Bolt” shpk**, nuk plotëson pikën 7 ne DST, **Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik** ku citohet:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë jo më pak se 2 (dy) mjete transporti me kapacitet mbajtes nga 2 ton deri ne 3.5 ton per secilin mjet.

Nga verifikimi në dokumentat e paraqitura nga operatori ekonomik “Bolt” shpk në sistemin elektronik të App-së rezulton se Operatori Ekonomik “Bolt” shpk, nuk e ka përmbushur kërkesen e vendosur nga Autoriteti Kontraktor ne lidhje me makinerite ku kerkohen 2 (dy) mjete transporti me kapacitet mbajtes nga 2 ton deri ne 3.5 ton per secilin mjet, pasi mjetet e paraqitura nuk janë në këtë kapacitet mbajtes.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Bolt” shpk është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik pika 7.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2- Operatori Ekonomik “Dajti Construxion” shpk

Operatori ekonomik **“Dajti Construxion”shpk**, nuk plotëson **Kriteret Veçanta Kualifikimit/ pika 2, gërma ç e DST**, ku citohet:

Në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në pikën 2/ç citohet: ç) Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Operatori Ekonomik “Dajti Construxion” shpk, ka paraqitur në sistemin elektronik Vërtetim Debie nr. 5937 dt.16.07.2018, sipas së cilës rezulton se nuk ka detyrime për faturat e energjisë elektrike, **pa përfshirë faturën koherente të muajit Korrik 2018**

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga “Dajti Construxion”shpk, lidhur me pika 2, gërma ç, është i paplotë, për rrjedhojë i pavlefshëm

Autoriteti Kontraktor në dokumentat standart të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 2.15, ka kërkuar:

..Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin mostra të cilat duhet të dorëzohen në ditën dhe orën

e hapjes së ofertave pranë AK. Lista e mostrave që duhet të paraqiten sipas specifikimeve teknike të dhënë në DST, të jenë:

Tavolinë ngrënie

Etazher i kuzhinës së mensës

Aksesorë për kuzhinë

Stol ngrënie

Mosparaqitja e mostrave dhe në përputhje me specifikimet teknike në ditën e hapjes së ofertave, është kusht skualifikues. Operatori Ekonomik fitues do ti mbahen mostrat deri në realizimin e kontratës ndërsa operatorëve ekonomikë jo fitues do tu kthehen mostrat e depozituara....”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, konstatoi se Operatori Ekonomik nuk paraqiti mostra në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë AK, më datë 11.09.2018.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Janë kualifikuar si oferta të suksesshme, këta ofertues :

1. Operatori Ekonomik ‘M.LEZHA’ shpk, kualifikohet në vend të parë.

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **4.037.600** (katërmilion e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) **lek**

Çmimi total i ofertës me TVSH = **4.845.120** (katërmilion e tetëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e njëzet) **lekë**.

Afati i dorëzimit të mallit brenda 2 (dy) muajve kalendarikë nga data e lidhjes së kontratës. Afati i dorëzimit i detajuar për cdo objekt, brenda periudhës 2 mujore do të përcaktohet në momentin e lidhjes së kontratës.

2. Operatori Ekonomik ‘Ro- AL’ shpk, kualifikohet në vend të dytë.

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **4.678.800** (katër milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) **lek**

Çmimi total i ofertës me TVSH = **5.614.560** (pesë milion e gjashtëqind e katërmbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) **lekë**.

Afati i dorëzimit të mallit brenda 2 (dy) muajve kalendarikë nga data e lidhjes së kontratës. Afati i dorëzimit i detajuar për cdo objekt, brenda periudhës 2 mujore do të përcaktohet në momentin e lidhjes së kontratës.

3. Operatori Ekonomik ‘ERZENI/SH’ shpk, kualifikohet në vend të tretë.

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **5.306.600** (pesë milion e treqind e gjashtë mijë e gjashtëqind) **lek**.

Çmimi total i ofertës me TVSH = **6.367.920** (gjashtëmilion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatëmijë e nëntëqind e njëzet) **lekë**.

Afati i dorëzimit të mallit brenda 2 (dy) muajve kalendarikë nga data e lidhjes së kontratës. Afati i dorëzimit i detajuar për cdo objekt, brenda periudhës 2 mujore do të përcaktohet në momentin e lidhjes së kontratës.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 14.09.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori Ekonomik “**Bolt**” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 34124 Prot. datë 17.09.2018 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: **”Paisja me orendi e 4 mencave në shkollat ku do të implementohet projekti ”Bëjmë detyrat e shtëpisë”**

Nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga Operatori Ekonomik i mësipërm dhe është konsideruar i drejte dhe i bazuar në ligj, Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Ky konkluzion i është rekomanduar Titullarit të Autoritetit Kontraktor si dhe është vënë në dijeni Operatorit Ekonomik, “**Bolt**” shpk, me ane të shkresës Nr.34142/2 datë 20.09.2018. (administruar në dosjen e prokurimit).

Operatorit Ekonomik, “**Bolt**” shpk, duke mos qenë dakort, me Vendimin e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik. Pranë Autoritetit Kontraktor është paraqitur Formulari i Ankesës, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën nr.35458 prot. datë 26.09.2018.

Komisioni i Prokurimit Publik, i është drejtuar Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Tiranë, me shkresën Nr 15301 Prot, datë 28.09.2018, hyrë në Bashkinë e Tiranës, me nr.36234 Prot, datë 02.10.2018 “Urdhër për pezullim procedure prokurimi”, “Shqyrtimi në themel”.

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, i vuri në dispozicion Komisionit të Prokurimit Publik, gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: **”Paisja me orendi e 4 mencave në shkollat ku do të implementohet projekti ”Bëjmë detyrat e shtëpisë”**. Informacioni u dërgua pranë KPP-së me anë të shkresës nr.36234/1 datë 05.10.2018 (administruar në dosjen e prokurimit).

Më datën 20.11.2018 pranë Bashkisë Tiranë ka mbërritur shkresa me nr. hyrës prot.43318 datë 20.11.2018, “Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik”, nr.782/2018 datë 16.11.2018, për procedurën e prokurimit me objekt **”Paisja me orendi e 4 mencave në shkollat ku do të implementohet projekti ”Bëjmë detyrat e shtëpisë”**, si më poshtë cituar:

Komisioni i Prokurimit Publik vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik “**Bolt**” shpk, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF -83755-08-24-2018, me objekt **”Paisja me orendi e 4 mencave në shkollat ku do të implementohet projekti ”Bëjmë detyrat e shtëpisë”**, me fond limit: **5.380.500** (pesë milion e treqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind) **lekë pa TVSH** zhvilluar në datën 11.09.2018, nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë
2. Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Për sa më sipër, në kuadër të Vendimit të Komisionit Prokurimit Publik dhe referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “**M.LEZHA**” shpk me adresë: Shkodër,

Zona Industriale, Rruga Lëvizja e Postribës, nr. Pasurie 11/200, zona kadastrale 8592, me nr. NUIS J76504013C, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH, **4.037.600** (katër milion e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) **lekë**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do ju konfiskohet sigurimi i ofertës(nëse është kërkuar), siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006, (i ndryshuar).

